

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E PEJËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **635-22-2641-1-2-1 635/22/013/121**

Sa i përket tenderit për: **Blerja e rentgenit te madh per QKMF**

### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

**S BAJRAKTARI 1 SH.P.K**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Jashnicë-Klinë  
(Adresa)

Klinë  
(Vendi)

32000  
(Kodi postar)

049171004  
(Numri Telefonit)

n/a  
(Numri i Faks-it)

Shaban Bajraktari  
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Hajzergashi254@gmail.com  
(Adresa elektronike)

SHPK  
**S.BAJRAKTARI 1**  
JASHNICË - KLINË  
*Shaban Bajraktari*  
(Nënshkrimi dhe vulë)

02.06.2022  
(Data e parashtrimit të kërkesës)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës

### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

N/A  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Aktiviteti i prokurimit është publikuar me datën: <b>31.03.2022</b> Pranimi/dorëzimi i ofertave me date: <b>25.05.2022 ora 14:00</b>
---

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☒

N/A
-----

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☐

Jo ☒

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

### KERKESE PËR RISHQYRTIM 20.05.2022

O.E ankues me date:

**20.05.2022** kemi paraqit kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të AK-së B54 - Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara të datës 12.05.2022 të publikuar në platformën elektronike të e-prokurimit.

### REFUZIMI I KERKESES 24.05.2022

Përmes e-prokurimit me date **24.05.2022** kemi pranuar vendimin nga ZPP për refuzimin të kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar.

**Dëshmitë:** Te bashkangjitura

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**

Neni 7 **Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**

Neni 27 **Dosja e Tenderit**

Neni 28 **Specifikimet teknike**

### **Rregullat te Udhezuesit Operativ per Prokurimin Publik**

Neni 10 Pika c **Funksionet e Njesisë së Kërkesës**

Neni 11 Pika c **Funksionet e Departamentit /Njesisë së Prokurimit**

Neni 20 **Specifikimet Teknike**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**Ankesë** kundër dokumenteve të tenderit dhe njoftimit për kontrat brenda afatit ligjor parashtrohet nga ankuesi si pale me interes material ne pajtim me Nenin 108/A Paragrafi 3.1 *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.*

**Specifikimet teknike favorizuese për NPT MEDICA SH.P.K nga njësia e kërkesës** Pretendim Ankimor-Specifikimet Teknike te Detyrueshme Aneksi 1- Favorizuese për prodhuesin SHIMADZU- RTGRADspeed Pro DR dhe prodhuesit CARESTREAM DRYVIEW 5950 Laser Imager te përpiluara nga njësia e kërkesës janë përgatitur për Operatorin ekonomik NPT MEDICA SH.P.K Autortieti kontraktues me daten: **12.05.2022** ne plateformen e-prokurimit ka ngritur dosjene tenderit te korrigjuar ne te cilen pasi kemi analizuar kërkesat e përzgjedhjes dhe specifikimet teknike te dosjes se tenderit ku kemi ardh ne konkulzion se ne TËRËSI- Specifikimet teknike te detyrueshme Ankesi 1 jane ne përputhje me produktin SHIMADZU- RTGRADspeed Pro DR dhe prodhuesit CARESTREAM DRYVIEW 5950 Laser Imager.

**Praktike e thjeshte:** Nese merren copy-paste specifikimet teknike te detyrueshme dhe vendosen ne [www.google.com](http://www.google.com), menjehere nderlidhen me prodhuesit qe kemi cek qe tregon haptas se jane favorizuese dhe kundërshtim me dispozitat e LPP-se. Përpilimi i specifikimeve teknike duke favorizuar prodhuesin nga Japonia dhe prodhuesin nga USA nga njësia e kërkesës bie ndesh me Nenin 28 Paragrafi 2 te LPP-se ‘Autoriteti kontraktues do t’i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është vecanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik’.

Përpilimi i specifikimeve teknike duke favorizuar prodhuesin nga Japonia dhe prodhuesin nga USA nga njësia e kërkesës bie ndesh me Nenin 20 te RrUOPP, si: Paragrafi 3 “Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo- diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, performanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimit.

Paragrafi 4 “Specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Perpilimi i specifikimeve dke favoziuar dhe diskriminuar prodhueses tjere me produkte te ketyre furnizimeve, eshte ne kundërshtim edhe me Direktiven e BE qe e rregullon si Parim te Nenin 20 te RrUOPP:

*Sa i përket direktivave të BE-së, parimi theksohet si në vijim:*

***“Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik.”***

Duke ju referuar dispozitave te lartcekura dhe Nenit 7 Paragrafi 1 dhe 2 te LPP-se:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Kerkojme nga **NJESIA E KERKESËS** te Komunes se Pejës te **MODIFIKOJ** ne tërësi këto specifikime teknike te detyrueshme duke mundesuar konkurrence ne mes te prodhueseve per produktin blerja e rentgenit qe jane te perafert me terma teknike qe nuk e ndryshojne kushtin material te kerkesave minimale teknike qe jane te nevojshme për njesine e kerkesës.

Per shkak se eshte procedure e hapur dhe kerkohet nga autoriteti kontraktues te mundesoj konkurrence ne mes te tenderueseve apo prodhueseve, atehere kerkojme nga njesia e kerkeses ti merr parasysh produktin DRGEM GXR-52SD te prodhuesit DRGEM dhe produktin e prodhuesit Codonics Horizon me rastin e modifikimit te specifikimeve teknike qe na mundeson pjesemarrjen ne kete procedure te prokurimit si te barabarte/shtim te konkurences me produktin e prodhuesit SHIMADZU dhe carestream qe jane te vendosura ne dosje te tenderit respektivisht specifikimet teknike te detyrueshme aneksi 1 qe jane favorizuese për NPT MEDICA SH.P.K.

**Te bashkangjitur:**

***Katalogu i prodhuesit SHIMADZU dhe CARESTREAM Qe janë ne ST te DT si favorizuese për OE NPT MEDICA SH.P.K***

***Katalogu i prodhuesve qe ne i përfaqesojme ne KOSOVE(DRGEM dhe CODONICS).***

Njesia e kërkesës me përpilimin e specifikimeve teknike te dosjes se tenderit qe janë ne tërësi favorizuese për NPT Medica shpk ka vepruar ne kundërshtim me Rregullat te Udhezuesit Operativ për Prorkuimn Publik, Neni 10 Funksionet e Njësisë së kërkesës, Pika c ***“Siguron që nuk ka kufizime në specifikime, ose TeR, në mënyrë që të sigurohet konkurrenca maksimale”***, andaj ne ketë rast nuk ka konkurrence maksimale por minimale apo vetëm një OE përmes prodhues te caktuar qe kemi cekur si me lartë.

## **PROPOZIM**

**TE APROVOHET-** Ankesa si e bazuar.

**TE MODIFIKOHET-**Specifikimi teknik i detyrueshem Aneksi 1 te DT sepse është përshtatur produktit/Katalogut te prodhuesit SHIMADZU dhe CARESTREAM.

**TË PËRFSHIHET** – Ne Specifikim teknik të Dosjes së tenderit produkti DRGEM GXR-52SD të prodhuesit DRGEM dhe produktin e prodhuesit Codonics Horizon në mënyrë që dosje e tenderit të jetë në pajtim me Nenin 7, 27 dhe 28 të LPP-se/trajtim i barabartë të prodhueseve apo OE në procedurë të Hapur dhe mosdiskrimin apo favorizim të prodhueseve që ka përpiqur njësia e kërkesës.

*Me respekt*

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

### **-Shpenzimet për përgatitjen e ofertës**

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*